

**Znj. Brunilda Zeneli (Hyka)** është diplomuar për Financë në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës, më pas ka kryer disa kualifikime, si: Certifikuar "Ekspert Kontabël dhe auditimi në Sektorin Publik" Chartered Institute of Public Finance and Accountancy (CIPFA) Angli & CEF-Slloveni, viti 2007; Certifikuar si Audit i Brendshëm në Sektorin Publik, nga Ministria e Financave, viti 2008; Diplomë "Postmaster në Administrim Biznes", Univeristet i Jopublik "S&P Qirjazi" viti 2011; ka ndjekur Kursin Pasuniversitar, ku ka marrë Titullin "Vlerësues i pasurive të paluajtshme" Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti i Tiranës, viti 2015.

Znj. Brunilda Zeneli (Hyka) nga viti 1990 deri në vitin 1998, ka punuar si financiere. Në vitin 1998-2006, ka mbajtur pozicionin e auditueses në KLSH. Nga viti 2007-2013, ka mbajtur pozicionin e Inspektore në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion në Kryeministri.

Në vitin 2013 ka filluar punë përsëri në KLSH në pozicionet si Audituese dhe Kryeaudituese në departamente të ndryshme auditimi si, në Departamentin e Auditimit të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, Departamentin e Auditimit të Performancës, Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore, Departamentin e Auditimit IT, Drejtorinë e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë. Në periudhën Maj 2020 deri në Shtator 2022, ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Metodologjisë dhe Zhvillimit. Ka një eksperiencë të gjatë pune në fushën e auditimit dhe kontrollit, prej 25 vjetësh.

Aktualisht, Znj. Zeneli (Hyka) është e emëruar në pozicionin e "Drejtores së Drejtorisë së Marrëdhënieve me Nënkomisionin Parlamentar".

Gjatë karrierës profesionale, ka ndjekur një sërë trajnimesh të ndryshme, brenda dhe jashtë vendit, në fushën buxhetit "Planifikimi dhe zbatimi i buxhetit" nga Gjykata e Kontrollit Austri dhe nga Cards Project; "Mbi auditimin e shpenzimeve buxhetore", nga Këshilli Britanik, Shqipëri; në fushën e prokurimeve publike, "Mbi prokurimin e punëve publike", nga Qendra Ndërkombëtare e Trajnimeve ILO, në fushën e antikorrupsionit "Mbi forcimin e luftës kundër korrupsionit", nga Crown Agents dhe nga PNUD, "Shkëmbimi i eksperiencave mes vendeve të Europës Juglindore, në luftën kundër korrupsionit" nga Agjencioni Antikorrupsion Kosovë, "Korrupsioni dhe mashtrimi, roli i audituesve", nga Center of Excellence in Financë (CEF)-Slloveni, si dhe në fushën e auditimit, nga SAI i Turqisë, Polonisë, Austrisë. Etj.